Nr. 2460/3 Prot
Dt. 25.06.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 625/4 Prot. Lezhë, më 24.06.2026

Lënda: **Konfirmim vendimi**

KËSHILLIT TË BASHKISË MIRDITË

Për dijeni: **KRYETARIT TË BASHKISË MIRDITË**

Bazuar në nenin 16, pika 2/b, të ligjit nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjin nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për proçedurat standarte të përgaditjes së programit buxhetor afatmesëm" i ndryshuar, udhëzimin nr.7, datë 27.02.2026 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për përgaditjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029" konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.52, datë 22.06.2026, "Për miratimin e dokumentit të parë, të programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2027-2029", bashkia Mirditë.

PREFEKTI

Taulant MALSHI

Adresa: Lagjja "Skenderbej" Lezhë Prefekti.Lezhe@mb.gov.al Tel. & Fax. 0215 22202

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2460/2 Prot Rrëshen, më 23 . 06 . 2026

VENDIM

Nr. 52 datë 22. 06. 2026
PËR
"MIRATIM E DOKUMENTIT TË PARË, TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM (PBA) 2027 - 2029", BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 68/2017, pika 3, neni 48, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 , i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" *i ndryshuar*, Udhëzimi nr. 7, datë 27.02.2026, i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029", të kalendarit PBA 2027 - 2029 dhe buxhetit të vitit 2027, i miratuar me VKB. nr. 109 datë 29.12.2025, "Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027", Bashkia Mirditë, VKB nr. 21, datë 19.03.2026, "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029", relacionin nr. 2460, datë 02.06.2026 dhe tabelat së bashku me projekt-vendimin paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, *shqyrtimin e miratimin në mbledhjen e datës 19.06.2026, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit*, për t'a kaluar në seancën e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

VENDOSI:

1. Të miratojë Dokumentin e Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027-2029, sipas relacionit nr. 2460 prot, datë 02.06.2026 dhe tabelave bashkëlidhur, *pjesë përbërse e këtij vendimi*

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë; (GMS & të gjitha drejtoritë dhe angjensitë e Bashkisë Mirditë)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë!

SEKRETAR
Gaspër TOPOLLAJ

KRYETAR
Aleksandër PLÇAKU

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI" RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al